



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

P/VENDIM

Nr. 13067 / Datë 19.07.2022

PËR

**“NJË SHITESË NË VKB-NË NR. 5, DATË 28.01.2020
“PËR MIRATIMIN E SISTEMEVE TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMET SOCIALE
TË STREHIMIT”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr 22/2018 “Për Strehimin Social”, neni 15 pika 3, VKM nr.362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij” pika 2 dhe 2.1, VKM nr. 384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore” pika 12, VKM nr.453 datë 03.07.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti” pika 13, Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lezhë nr. 5, datë 28.01.2020 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programet sociale të strehimit”, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit të Bashkisë:

PËR TË VENDOSUR:

1. Miratimin e një shtesë në pikën I/1 të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë nr. 5 datë 28.01.2020 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programet sociale të strehimit”, duke u shtuar pika 3 me përmbajtje si më poshtë:
 - Në rastet kur në listën e familjeve përfituese kemi më shumë se një familje me pikë të barabarta përzgjedhja e aplikanteve përfitues do të bëhet nëpërmjet shortit të organizuar nga Komisioni i Strehimit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

KRYETARI
Pjerin NDREU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

Nr. 3064 Prot,

Lezhë, më 8 /07 /2022

Lënda: Relacion për projektvendimin “Për një shtesë në VKB-në nr. 5, datë 28.01.2020, “Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet sociale të strehimit”

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

KËTU

Ne nenin 15 pika 3 e ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social” parashikon se Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore hartojnë, miratojnë dhe publikojnë sistemin e pikëzimit, për çdo vit, të specifikuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore dhe për çdo program që zbatohet në ato, bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë ligj. Gjithashtu në nenin 15 pika 1 e ligjit 22/2018 parashikon se përzgjedhja e subjekteve dhe familjeve përfituese bëhet nëpërmjet një sistemi pikëzimi, i cili miratohet dhe publikohet për çdo program nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në parimet e parashikuara në këtë ligj, si dhe kriteret e bëra publike përpara fillimit të procesit të aplikimit.

Me VKB-në nr. 5, datë 28.01.2020, “Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet sociale të strehimit” është miratuar sistemi i pikëzimit për përzgjedhjen e subjekteve dhe familjeve përfituese për programin e subvencionit të qirave të banimit dhe të programit të subvencionit të interesave të kredive.

Në vendimin e mëparshëm të Këshillit të Bashkisë Lezhë nuk është parashikuar një zgjidhje për rastet kur ka shumë aplikantë që kanë numër të njëjtë pikësh dhe potencialisht të gjithë janë përfitues nga programi i strehimit për subvencionin e interesave të kredive dhe qirave të banimit. Për ti dhënë një zgjidhje kësaj problematike dhe në mënyrë që përzgjedhja e përfituesve të bëhet në mënyrë sa më transparente nëpërmjet këtij projektvendimi propozojmë miratimin e një shtese në Vendimin e Këshillit Bashkiak të sipërcituar duke përcaktuar si mënyrë përzgjedhje të përfituesve me pikë të barabarta shortin që do të organizohet nga Komisioni i Strehimit i ngritur po me vendim të Këshillit Bashkiak.

Për arsytet e sipërcituara i jemi drejtuar Këshillit të Bashkisë Lezhë me propozimin për të vendosur miratimin e një shtese në VKB-në nr. 5, datë 28.01.2020, “Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet sociale të strehimit”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Drejtor i Shërbimit dhe Kujdesit Social

Marte Fetaj

Konc: Nermina Shehi